

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Rasim Rasimi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Mirlinda Mejzini-Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarve A.S., N.B., M.Th., nga F. dhe Sh.D., S.H. dhe F.H., nga R. e Shqipërisë, për shkak të veprës penale blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psiko-trope dhe analoge nga neni 273 par. 2 lidhur me nenin 281 par 1 nën par.1.1 të KPRK, i dënuari N.B. edhe për shkak të veprave penale posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psiko-trope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit N.B., paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, PKR.nr.107/2015 datë 27.02.2016, dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.270/2016 datë 29.06.2017, në seancën e kolegjit e mbajtur më 10 prill 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit N.B., e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, PKR.nr.107/2015 datë 27.02.2016, dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.270/2017 datë 29.06.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR.nr.107/2015 datë 27.01.2016, të dënuarit A.S., S.H. dhe F.H. janë liruar nga akuza për shkak të veprës penale blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni

273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 të KPRK, konform nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPK, Sipas Dispozitivit I/1.

Të dënuarit N.B., M.Th. dhe Sh.D., janë shpallur fajtor sipas dispozitivit I/I, për shkak të veprës penale blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 të KPRK, i dënuari N.B. është shpallur fajtor edhe për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psiko-tropike ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK.

Të dënuarit N.B. për veprën penale në dispozitivin e parë të aktakuzës për veprën penale blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 të KPRK, i ka përcaktuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite dhe dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqindën) €, për veprën penale nga dispozitivi nën II, posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psiko-tropike ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK, i ka përcaktuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve dhe dënimin me gjobë në shumën prej 200 (dyqindën) €, për veprën penale nga dispozitivi nën III, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK i ka përcaktuar dënimin me gjobë në shumën prej 300 (treqindën) € dhe i ka shqiptuar dënimin unik me burg në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve e 3 (tre) muaj dhe dënimin me gjobë në shumën prej 1.000 (njëmijë) €.

Të dënuarit M.Th., për veprën penale nën I të dispozitivit, blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 të KPRK, i ka shqiptuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3(tri)viteve dhe dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqindën) €.

Të dënuarit Sh.D., për veprën penale nën pikën I të dispozitivit, blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 të KPRK, i ka shqiptuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3(tri) viteve dhe dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqindën) €.

Koha e kaluar në paraburgim, prej 05.07.2014 deri më 27.01.2016, të dënuarve do t'ju llogaritet në dënimin e shqiptuar me burg ndërsa dënimi i shqiptuar me gjobë ndaj të dënuarve do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi në të kundërtën i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu ashtu që për një ditë burgu do të llogariten 20 €. Konform nenit 274 par.1 të KPPK, kundër të dënuarve Sh.D. dhe M.Th., bëhet konfiskimi përhershëm i veturave të markës “Mercedes” me targa TR dhe veturën e markës “R..” L... me targa ..-...-GL pasi që të njëjtat janë përdorur për kryerjen e veprave penale. Konform nenit 273 par.5 dhe 275 par.3 të KPPK, lëndët narkotike të sekuestruara konfiskohen në mënyrë të përhershme nga të dënuarit si dhe në pajtim me nenin 374 par.3 të KPRK konfiskohet në mënyrë të përhershme arma e sekuestruar nga i dënuari N.B. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi udhëzohet Agjencia për Administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar që ta shes pasurinë e luajtshme-veturën e tipit “M...” me targa TR-L pronë e të dënuarit Sh.D. dhe veturën e markës “R...” L... me targa ..-...-GL pronë e të dënuarit M.Th. Urdhërohet Policia e Kosovës DHTN në Ferizaj që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin e substancave narkotike. Secili nga të dënuarit obligohet që në emër të shpenzimeve të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 50 €.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.270/2016 të datës 29.06.2017, i ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj dhe ankesat e mbrojtësve të dënuarve Sh.D., N.B. dhe M.Th., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit N.B. , av. A.I. nga F., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 të KPPK dhe shkeljes së ligjit penal nga neni 385 par.1 nënpar.1.4 të KPPK, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Prokurori i Shtetit, me parashtresën KMLP.II.nr.177/2017 e datës 25.09.2017, ka paraqitur përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parashikuar me dispozitën e nenit 384 par.1 pika 1.12 të KPPRK, ngase dispozitivi i aktgjykimit nuk përmban fakte dhe rrethana që supsimojnë tiparet qenësore të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 të KPRK-së. Në dispozitiv në përshkrimin faktik nën pikën II që i referohet të dënuarve N.B., M.Th. dhe Sh.D., nuk prezantohet lloji i narkotikeve dhe sasia e narkotikeve që është objekt i veprës penale, e që mangësia e cekur dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë e bënë të paqartë dhe të pa kuptueshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa ka gjetur se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimi i kundërshtuar, rezulton se i dënuari N.B., pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, e duke i ditur pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë me vullnet dhe vetëdije të plotë e ka pranuar fajësinë për veprat penale që i viheshin në barrë sipas aktakuzës. Mbrojtësi i të dënuarit e ka mbështet pranimin e fajësisë së të dënuarit, i cili pranim është bërë me vullnetin e tij të plotë.

Gjykata Supreme e Kosovës, i vlerësojë si të pabazuara pretendimet nga kërkesa e mbrojtësit të dënuarit N.B., lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale. Dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë në raport me të dënuarin është i qartë dhe konkret, nuk ka kundërthënie me vetveten dhe me arsyetimin, përshkrimi i dhënë në dispozitiv është konkret dhe i kuptueshëm, me asgjë i njëjti nuk mund të sillet në dyshim. Në dispozitiv janë të përshkruara të gjitha veprimet inkriminuese për të dënuarin, ndërsa arsyetimi përmban arsye të duhura mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje juridiko-penale.

Po ashtu pretendimet e mbrojtësit se aktgjykimi nuk është i përpiluar në pajtim me nenin 370 e që sipas mbrojtësit nuk prezantohet lloji i narkotikut dhe sasia e narkotikut që është objekt i veprës penale nuk qëndron, pasi që gjykata e shkallës së parë provat i ka vlerësuar drejt në pajtim me dispozitën e nenit 361 par.1 e 2 të KPPK. Nga shkresat e lëndës shihet se Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin PKR,nr.139/14 e datës 17.10.2016, sipas detyrës zyrtare ka bërë

përmirësimin dhe plotësohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR.nr.107/15 datë 27.01.2016, në të cilin aktvendim është konstatuar lloji dhe sasia e narkotikëve Marihuanë me sasi prej 7.811.42 gr. (shtatë mijë e tetëqind e njëmbëdhjetë e dyzetë dy gram).

Pretendimet e mbrojtësit të dënuarit se është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit, po ashtu janë të pabazuara. Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e dytë drejtë kanë zbatuar ligjin penal kur kanë gjetur se në veprimet e të dënuarit N.B. ekzistojnë elementet e veprave penale blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 të KPRK, dhe veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psiko-trope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK, andaj pretendimi i mbrojtësit se gjykata është dashur të dënuarin ta shpall fajtor për një vepër sepse vepra penale posedimi i paautorizuar i narkotikeve nga neni 275 par.1 të KPRK absorbohet në veprën blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 të KPRK, është i pabazuar. Nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimi i kundërshtuar shihet se në veprimet e të dënuarit ekzistojnë elementet e dy veprave penale e jo të një vepre penale siç pretendohet në kërkesën e mbrojtësit të dënuarit. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar se në veprimet e të dënuarit qëndrojnë elementet e veprës penale blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1 nënpar.1.1 të KPRK, sepse siç rezulton nga dispozitivi nën I/I, i aktgjykimit të shkallës së parë i dënuari N.B. me të dënuarit M.Th. dhe Sh.D., ditën kritike në rrugën regjionale Shtime - Ferizaj në afërsi të pompës së benzinës "H..P...", me rastin e ndaljes për kontroll nga njësia e DHTN-së në Prishtinë të veturës "R..I...." me targa ...-...-CL, të cilën e drejtonte i pandehuri M.Th., në bagazhin e veturës është gjetur substancë narkotike e llojit Marihuanë me peshë neto 7.811.42 gr. (shtatë mijë e tetëqindën e njëmbëdhjetë e dyzet e dy gram) të cilën të dënuarit si anëtar të grupit pa autorizim e kanë transportuar nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Kosovës me qëllim shitje. Edhe për veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikeve nga neni 275 par.1 të KPRK, sepse siç rezulton nga dispozitivi nën II/2, i dënuari N.B., më datë 05.07.2014 në banesën e tij e cila gjendet në rrugën "H.J." në F., pa autorizim ka poseduar substancë narkotike të llojit "marihuanë" në peshë neto 6 gr. Andaj, nga përshkrimi i këtillë faktik në dispozitivat e aktgjykimit rezulton se kemi të bëjmë me dy vepra penale të ndara, për të cilat vepra veprimet inkriminuese janë të posaçme sipas neneve

përkatëse të cekura si më lartë, ashtu që gjykata ka bërë kualifikimin e drejt të këtyre veprave në bazë të përshkrimit faktik.

Për arsyet e paraqitura më lartë rezultojnë të pabazuara pretendimet nga kërkesa për mnrojtje të ligjshmërisë , andaj e në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË
Pml.nr.255/2017, më 10 prill 2018

Procesmbajtësja,
Mirlinda Mejzini-Simnica

Kryetarja e kolegjit,
Emine Mustafa